



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË

Nr. 1756 prot.,

Vlorë, më 10 . 02 .2023

PROJEKT- VENDIM

Nr. _____ datë ____ . ____ 2023

**PËR MIRATIMIN E DEKLARATËS PËR BASHKËFINANCIM DREJTUAR
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË, PËR “PROGRAMIN E
PËRMIRËSIMIT TË KUSHTEVE TË BANESAVE EKZISTUESE PËR KOMUNITETE
TË VARFËRA DHE TË PAFAVORIZUARA”**

Këshilli i Bashkisë Vlorë, në mbështetje të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8 pika 1 dhe 2, neni 9 pika 1.1/b, neni 24 pika 1.2, të ligjit nr.22/2018 datë 03.05.2018 “Për strehimin social”, neni 40, 41, 42, 43, të VKM Nr.454 datë 03.07.2019 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese”, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Drejtoria e infrastrukturës dhe Investimeve Publike;

VENDOSI

- I. Të miratojë deklaratën për bashkëfinancim drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për “Programin e përmirësimit të kushteve të banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara”.
- II. Të miratojë financimin për projektet e përmirësimit të kushteve të 8 banesave për vitin 2023 në masën 30% nga buxheti i Bashkisë Vlorë dhe 70% nga buxheti i shtetit, përkatësisht , 1 720 975.5 lekë me tvsh nga Bashkia Vlorë dhe 4 015 609.5 lekë me tvsh nga buxheti i shtetit. Ku kostoja totale për riparimin e këtyre banesave sipas projekt-preventivit të hartuar është 5 736 585 lekë me tvsh.
- III. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike, si edhe Drejtoria e Financës pranë Bashkisë Vlorë.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr.139/2015 date 17.12.2015, neni 55, pika 6.

Juristi: *S.Haxhiraj*
Drejtori: *Z.Selmani*

KRYETARI

Dritan Deli



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA V Lorë
DREJTORIA E INFRASTRUKTURËS DHE INVESTIMEVE PUBLIKE

RELACION

Për projekt-vendimin

**PËR MIRATIMIN E DEKLARATËS PËR BASHKËFINANCIM DREJTUAR
MINISTRISË SË FINANCIVE DHE EKONOMISË, PËR “PROGRAMIN E
PËRMIRËSIMIT TË KUSHTEVE TË BANESAVE EKZISTUESE PËR KOMUNITETE
TË VARFËRA DHE TË PAFAVORIZUARA”**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8 pika 1 dhe 2, neni 9 pika 1.1/b, neni 24 pika 1.2, të ligjit nr.22/2018 datë 03.05.2018 “Për strehimin social”, neni 40, 41, 42, 43, të VKM Nr.454 datë 03.07.2019 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese”, Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën Nr.23964prot., datë 28.12.2022 “Mbi fondet për programet e strehimit për vitin 2023”, ka njoftuar të gjitha njësitë vendore mbi fondet e planifikuara për programet e strehimit për vitin 2023, duke i ftuar të aplikojnë për mbështetje buxhetore sipas ligjit nr.22/2018, datë 03.05.2018 “Për strehimin social”. Njoftimit për aplikim i bashkëlidhen “Termet e referencës për projektet e investimit që do të financohen nga buxheti i shtetit në vitet 2023-2024”, që parashikojnë;

1. Llojet e projekteve që do të financohen nga buxheti i shtetit dhe kufinj të financimit,
2. Kushtet që duhet të plotësojë bashkia për t’u kualifikuar, formatin e aplikimit, dokumentacionin që do të hartohet për projektin, si dhe dokumentacionin që do të dorëzohet pranë MFE-së për t’ju paraqitur Komisionit të Vlerësimit të Projekteve për shqyrtim dhe vlerësim (Dosja e aplikimit). Nisur nga kërkesat e regjistruara pranë Bashkisë Vlorë nga familje/individë, të cilët disponojnë banesa të amortizuara në një ose më shumë pjesë të tyre, janë të papërshtatshme për banim të mëtejshëm, apo rrezikojnë jetën e banorëve nga mungesa e investimeve dhe e riparimeve ndër vite, për shkak të problematikave ekonomike dhe sociale të vazhdueshme, po kështu nisur nga numri total i personave që përfitojnë për çdo program, nga ana jonë është zgjedhur aplikimi në programin e përmirësimit të kushteve të banimit për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara, në projektin e përmirësimit të kushteve të banesave ekzistuese. Familjet që përfitojnë nga ky projekt bëjnë pjesë në kategoritë e mëposhtme:

- familje pa të ardhura, sipas përcaktimeve të shkronjës ç, të pikës 45, të nenit 2, të ligjit 22/2018
- minoriteti rom dhe egjiptian
- familje me persona PAK
- e përbërë nga të moshuar me moshë mbi 65 vjeç
- familjet me më shumë se katër fëmijë
- vajzat nëna
- grua viktimë e dhunës
- grua kryefamiljare ku fëmijët në ngarkim të kenë moshën nën 18 vjeç.


Krahas kësaj janë përcaktuar edhe kufinj të financimit për secilën nga kategoritë e mësipërme.

MF&E në termat e referencës ka përcaktuar edhe përqindjen e bashkëfinancimit që i takon të financojë çdo bashki nga buxheti i saj sipas pikës 7 të Udhëzimit të Ministrit nr.31, datë 18.11.2019, sipas nivelit të të ardhurave vjetore për frymë për çdo bashki për vitin 2021 të përcaktuar me tabelë. Nisur nga kjo Bashkia Vlorë merr përsipër të financojë 30% të koston totale të projektit të hartuar për rregullimin e 8 banesave me kosto totale të projektit = prej 5 736 585 lekë me tvsh, duke kërkuar nga MF&E të financojë 70% të kësaj kostoje.

Sa më sipër me anë të këtij projekt-vendimi, i kërkojmë Këshillit të Bashkisë Vlorë, që të miratojë parimisht deklaratën e bashkëfinancimit të projektit “Përmirësim i kushteve të banesave ekzistuese” në masën 30% nga buxheti i Bashkisë Vlorë dhe 70% nga buxheti i shtetit. Në vlerat përkatësisht, 1 720 975.5 lekë me tvsh nga Bashkia Vlorë dhe 4 015 609.5 lekë më tvsh nga buxheti i shtetit.

Drejtor

Z. Selmani



Specialiste

D.Mustafai

